



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 168/prot.
3

Tiranë, më 24.03.2023

VENDIM

Nr. 968, Datë 24.03.2023

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE PEEL NRE WIND FARMS (YELL) LIMITED DHE PEEL NRE WIND FARMS (NO.1) LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT UK LTD”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24. 03. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi transaksionin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.

Referuar dokumentacionit të paraqitur, palët janë:

Pala blerëse: Statkraft UK Ltd, është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Anglisë, me objekt aktiviteti: Zhvillimi dhe operimi i projekteve të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, gjenerimit dhe tregtimit të energjisë elektrike dhe të furnizimit me energji. Statkraft UK Ltd zotërohet 100% nga Statkraft AS (shoqëria mëmë e Grupit Statkraft), një shoqëri lider në sektorin e hidroenergjisë në Evropë.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V: Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devoll Hydropower SHA, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Pala shitëse: Peel NRE Renewables (IOM) Limited, është një shoqëri e kufizuar në kuota, me adresë në Billown Mansion, Isle of Man.

Shoqëritë Target: Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited janë shoqëri të themeluara sipas legjislacionit të Anglisë, me objekt aktiviteti: Zhvillimin e dy fermave të prodhimit të energjisë nga era në Ishujt Shetland në Mbretërinë e Bashkuar.

Shoqëritë Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited, zotërohen 100% nga shoqëria Peel NRE Renewables (IOM) Limited. Shoqëritë Target nuk janë prezente dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Referuar dokumentacionit zyrtar të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, rezulton se: Blerësi Statkraft UK Ltd është në proces negociimi të lidhjes së Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve me shitësin Peel NRE Renewables (IOM) Limited. Pas lidhjes së kësaj Marrëveshje, me përmbushjen e kushteve të mbylljes (të cilat do të përkufizohen në Marrëveshje), shitësi do të shesë të gjitha aksionet e zotëruara në kapitalin e shoqërive target, Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited.

Shitësi është i angazhuar në një proces shitje në ankand nëpërmjet këshilltarëve të tij financiar të projekteve të fermave të erës dhe blerësi është zgjedhur pas këtij procesi si ofertues i preferuar. Pas marrjes së autorizimit nga Autoriteti i Konkurrencës palët synojnë të mbyllin sa më shpejt transaksionin.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited, nga shoqëria Statkraft UK Ltd, e cila do të bëhet efektive me nënshkrimin e Marrëveshjes dhe plotësimit të Kushteve Paraprake. Referuar dokumentacionit si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Në zbatim të nenit 60 pika 1 të ligjit 9121/2003, pala njoftuese ka kërkuar Autorizimin e Përqendrimit të Përkohshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët.

Përqendrimi i njoftuar pritet të mos krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Autoriteti i Konkurrencës gjykon të nevojshëm dhënien e autorizimit të përqendrimit të përkohshëm deri në depozitim e marrëveshjes së nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 56 pika 1 dhe nenit 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.
2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA

Rezana KONOMI

Adriana BERBERI

Durim KRAJA

Zv/Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Denar BIBA

Kryetar